

PARATHËNIE

Siguria njerëzore është e “qendëruar kah populli” – ajo i vë individët dhe bashkësitë e tyre si pikë kryesore të referimit. Krijimi i një kulture të politikës globale, të bazuar në të drejtat për të gjithë, është kërkesë e domosdoshme për përmirësimin e sigurisë njerëzore.

Siguria njerëzore kërkon kuptimin e vërtetë të të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, si kryesuese e Rrjetit të Sigurisë Njerëzore, si tema prioritare të Rrjetit të Sigurisë Njerëzore për vitin 2002/2003, kam caktuar Arsimimin për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijët e Prekur nga Konfliktet e Armatosura.

Arsimimi për të Drejtat e Njeriut, përmes bartjes së dijes, ndërtimit të aftësive dhe dimensionit të formimit të sjelljeve, ngre vetëdijen tonë të përgjithshme për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të sigurisë njerëzore. Për këtë qëllim, unë kam autorizuar Qendrën Evropiane të Trajnimit dhe Hulumtimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci në Grac, që me ndihmën e rreth 30 ekspertëve ndërkombëtarë, duke përfshirë institucionet e Partnerëve të Rrjetit të Sigurisë Njerëzore nga pesë kontinente, të përpilojë një Doracak për Kuptimin e të Drejtave të Njeriut. Ky doracak është destinuar që përmes perspektivës së sensitivitetit kulturor të bazuar në universalitetin e të drejtave të njeriut, të ketë përdorim global.

Ky doracak ndërtohet mbi bazat e Deklaratës mbi Parimet e Arsimimit për të Drejtat e Njeriut dhe të Sigurisë Njerëzore, miratuar nga Ministrat e Rrjetit gjatë takimit të tyre në maj të vitit 2003 në Grac, qytetin e parë të të Drejtave të Njeriut në Evropë. Synohet që ky doracak të jetë një kontribut afatgjatë nga Rrjeti i Sigurisë Njerëzore, nën kryesinë e Austrisë për sigurinë njerëzore të popujve, sot dhe në të ardhmen.

Besoj se ky Doracak do të ndihmojë Partnerët e Rrjetit, por dhe më gjerë, në përpjekjet e tyre për Arsimim për të Drejtat e Njeriut dhe Komisarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në përmbushjen e mandatit të tij, dhe, gjithashtu, të kontribuojë dhe inspirojë më tutje edhe aktivitetet jashtë Dekadës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.



Dr. Benita Ferrero-Waldner

Ministre e Punëve të Jashtme e Austrisë

Grac, Takimi i Pestë Ministror i Rrjetit të Sigurisë Njerëzore

9 maj 2003

MIRËNJOHJET

Duke u besuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Austrisë, në gusht të vitit 2002 ETC-ja (Qendra Evropiane e Trajnimit dhe Hulumentimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci), ka filluar hartimin e Doracakut “Kuptimi i të Drejtave të Njeriut”, ku me rastin e Takimit Ministror të Rrjetit të Sigurisë Njerëzore të mbajtur prej 8-10 maj 2003 në Grac, me qëllim të zhvillimit të konceptit të doracakut, janë ftuar partnerët e Rrjetit të Sigurisë Njerëzore dhe më gjerë, që të kontribuojnë për kompletimin e tij. Gjatë dy takimeve të ekspertëve, të mbajtura nga Ministria e Punëve të Jashtme e Austrisë, një numër i madh i ligjëruesve- ekspertë dhe praktikantë për të drejtat e njeriut nga shtetet anëtare të Rrjetit të Sigurisë Njerëzore, janë ftuar të kontribuojnë në këtë përpjekje edukuese, ndërkulturore, brezore dhe vërtet të re, për të drejtat e njeriut.

Doracakut “Kuptimi i të Drejtave të Njeriut” ka dalë si rezultat i shkathtësisë, profesionalizmit të madh dhe energjisë së parreshtur të shumicës së bashkëpunëtorëve.

Një falënderim i posaçëm u shkon autorëve dhe kontribuesve kryesorë për përkushtimin e tyre të jashtëzakonshëm në punë:

Hyrje në Sistemin e të Drejtave të Njeriut: *Wolfgang Benedek*, ETC-Grac;

Ndalimi i Torturës: *Minna Nikolova*, ETC;

Liria nga Varfëria: *Alpa Vora*, YUVA dhe *Minar Pimple*, Nagpur, PDHRE (Dekada Popullore për Arsim për të Drejtat e Njeriut) Indi;

Mosdiskriminimi: *Eva Schöfer*, ETC-Grac; E Drejta në Shëndet: *Kathleen Modrowski*, PDHR, New York;

Të Drejtat e Grave: *Susana Chiarotti*, PDHRE/CLADEM, Argjentinë dhe *Anke Sembacher*, ETC-Grac; Sundimi i Ligjit dhe Gjykimi i Drejtë: *Leo Zwaak* dhe *Hatice Senem Ozyavuz*, SIM-Utrecht, *Angelika Kleewein*, ETC-Grac;

Liritë Fetare: *Petra Sulovska*, ETC-Grac;

Të Drejtat e Fëmijës: *Helmut Sax*, BIM (Instituti për të Drejtat e Njeriut, Ludwig Boltzmann)-Vjenë;

Të Drejtat e Njeriut gjatë Konfliktit të Armatosur: *Alexandra Kleewein dhe Antoine A. Bouvier*, ICRC (Kryqi i Kuq Ndërkombëtar) Grupi i Gjenevës: *Angelina Kleewein*, ETC-Grac;

Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave: *Wolfgang Benedek*, Universiteti i Gracit dhe ETC-Grac;

Demoracia: *Satya Das*, Qendra për Paqe dhe të Drejta të Njeriut John Humphrey, Edmonton, Kanada dhe *Christoph Wertisch, Angelika Kleewein, Minna Nikolova dhe Catrin Pekari*, ETC-Grac

Burimet Plotësuese: *Angelika Kleewein, Verena ahousen, Claudia Pekari, Evelin Kammerer dhe Petra Sulovska*, ETC-Grac

Vështrim i Përgjithshëm mbi Metodologjinë e Arsimimit për të Drejtat e Njeriut: *Claudia Pekari*, ETC

Korrektura: *Elisabeth Ernst-McNeal dhe Suzanne Marlow*, Universiteti i Gracit

Disenji: *Markus Garger, Robert Schrotthofer dhe Wolfgang Gosch*, Kontrapart-Grac

Editorët dhe koordinuesit e projektit: *Wolfgang Benedek dhe Minna Nikolova*, ETC-Grac

Shprehim falënderim të posaçëm për rrjetin e PDHRE, për kontribut të madh për hartimin e këtij doracakut. Shprehim falënderimet më të sinqerta për ekspertët, këshilltarët, shokët dhe institucionet vijuese për përkrahjen e vazhdueshme, komentet e çmuara dhe sugjerimet për realizmin e doracakut:

Shulamith Koenig – Lëvizja Popullore për Arsimim për të Drejtat e Njeriut (PDHRE) – New York, *Adama Samassekou* dhe ekipi i PDHRE – Mali, *Renate Kicker* – Universiteti i Gracit, *Manuela Rusz* dhe ekipi i Institutit për të Drejtën Ndërkombëtare dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Universitetit të Gracit, *Anton Kok* – Qendra për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Pretorias, *Yannis Ktistakis* – Fondacioni Marangopoulos për të Drejtat e Njeriut – Athinë, *Otto König* – Universiteti i Gracit, *Debra Long* dhe *Barbara Bernath* – Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT) – Gjenevë, *Gerd Oberleitner* – London School of Economics and Political Sciences, *Christian Pippan* – Fakulteti Juridik, Universiteti i New Yorkut, *Yvonne Schmidt* – Universteti i Gracit, *Manfred Nowak* – Instituti për të Drejtat e Njerit Ludwig Boltzmann (BIM) – Vjenë, *Monique Prindezis*

CIFEDHOP – Gjenevë, Lidhja e Anti-Shpifjes (ADL) – New York, Komiteti Ndërkombëtr i Kryqit të Kuq (ICRC) – Gjenevë dhe ekipi i Sektorit për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë, nën kryesinë e Georg Mautner-Markhof dhe Ursula Werther-Pietsch.

SI TË PËRDORET KY DORACAK

Ideja për një doracak të përgjithshëm për arsimimin në fushë të të drejtave ka ardhur nga ETC-ja në Grac (Qendra Evropiane e Trajnimit dhe Hulumtimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci), si kontribut konkret për punën e Rrjetit të Sigurisë Njerëzore (HSN) gjatë kryesimit Austriak. Ministira e Punëve të Jashtme e Austrisë ia besoi një ekipi nga ETC-ja zhvillimin e kornizës ideore dhe hartimin e librit.

Doracaku “Kuptimi i të Drejtave të Njeriut”, është paraparë si mjet për të ndihmuar arsimimin për të drejtat e njeriut për ata që mësojnë, edukatorët e shteteve anëtare të Rrjetit të Sigurisë Njerëzore (HSN) dhe më gjerë, në përpjekjet e tyre për të mësuar sfonde të ndryshme kulturore, si strategji për përmirësimin e sigurisë njerëzore. Ashtu si është disenjuar, ky doracak mund të shërbejë si pikë e dobishme fillestare për kuptimin e të drejtave të njeriut, si dhe të padrejtësive, me qëllim të trajnimit të trajnuesve të ardhshëm dhe për hapjen e forumit të diskutimit për shkëmbime ndërkulturore dhe të njohurive.

Doracaku paraqet një përmbledhje të zgjedhur teorike, të ndërtuar përmes praktikës, që gjithashtu ofron komponentën për ndërtimin e aftësive dhe formimin e qëndrimeve. Temat e ndryshme të trajtuara këtu, kanë qëllim kryesor stimulimin e hulumtimeve të një qëndrimi të përbashkët dhe të një perspektive të ngjashme njerëzore, si dhe paraqitjen e çështjeve kontraverse shikuar nga perspektiva e ndieshmërisë kulturore.

Doracaku përbëhet nga tri pjesë kryesore, të cilat janë: hyrja e përgjithshme në bazat e të drejtave të njeriut, pjesa speciale me “*çështjet kryesore*” në formë të moduleve, të cilat duhet të ndihmojnë për kuptimin e funksionimit të të drejtave të njeriut në jetën e përditshme dhe e treta, e ashtuquajtura “*pjesa e burimeve plotësuese*”, e cila përmban informata të dobishme për institucionet e rëndësishme, referenca për lexime plotësuese dhe burime on-line.

Për të lehtësuar orinentimin në këtë libër, do t’ju ndihmojnë shenjat e poshtëshënuara:

 - e domosdoshme të dihet;

 - praktika të mira;

 - pyetjet për diskutim;

 **1**  **2** - aktivitete të zgjedhura;

 - perspektiva ndërkulturore dhe çështjet kontraverse;

 - për më shumë informata shiko

Ky doracak mund të përdoret nga shfrytëzues të ndryshëm dhe në mënyra të ndryshme. Përmes strukturës së tij fleksibile dhe të lehtë, kemi bërë përpjekje të inkurajojmë leximin kritik dhe kuptimin aktiv, si tek ata që mësojnë, ashtu edhe tek edukatorët. Në qoftë se kërkon konceptet dhe parimet kryesore të të drejtave të njeriut për një njohuri të përgjithshme, mund të filloni me pjesën e parë të doracakut, që përmban hyrjen. Ata që kërkojnë shembuj konkretë nga çështjet e të drejtave të njeriut, apo çelësin për arritjen e sigurisë njerëzore, gjurmimin e tyre mund të fillojnë në pjesën e moduleve “*e dobishme për të ditur*”. Në qoftë se kërkon analiza sistematike dhe të thelluara për ndonjë çështje nga të drejtat e caktuara, mund të filloni me pjesët e moduleve të ndryshme “*e domosdoshme të dihet*”. Kurse, ata që janë të interesuar të hulumtojnë ose ligjërojnë për të drejtat e njeriut në bazë të metodologjive të reja mësimore, si të adoleshentëve, ashtu edhe të të rriturve, mund të kalojnë drejtpërdrejt te pjesët e moduleve mbi aktivitetet e zgjedhura dhe të shikojnë vërejtjet e përgjithshme mbi metodologjinë e të drejtave të njeriut. Doracaku pretendon të jetë i pakufizuar dhe qëllimisht trajton vetëm një numër të zgjedhur të çështjeve më të rëndësishme. Dëshirojmë t’ju inkurajojmë që me shembuj, tregime, pyetje dhe përvoja të kontekstit tuaj personal, të plotësoni vazhdimisht këtë doracak.

Mirëpresim çfarëdo reagimi, pasi që kjo na ndihmon neve të plotësojmë doracakun në pajtim me ambiciet e tij për të qenë i dobishëm për ata që mësojnë, edukatorët si dhe për trajnuesit, të cilët vijnë nga kulturat e ndryshme dhe kanë shkallë të ndryshme të njohurisë për të drejtat e njeriut. Kënaquni me këtë libër dhe ndihuni të lirë që duke i

shtuar praktikat tuaja të mira dhe të shkëlqyeshme, si dhe brengat e komuniteteve tuaja, t'i kontribuoni kësaj pune që është në zhvillim, dhe gjithashtu inkurajoni sa më shumë njerëz që të lexojnë dhe kuptojnë enegjinë e aktualitetit dhe magjepsjen e vazhdueshme e të drejtave të njeriut.

Wolfgang Benedek and Minna Nikolova, at: office@etc-graz.at

LISTA E SHKURTESAVE

ACHR – American Convention on Human Rights; (Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut)

ACHPR – African Convention on Human and People's Rights; (Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve)

ACF – African, Caribbean and Pacific States; (Shtetet Afrikane, Karaibe dhe Pacifike)

ANC – African National Congress; (Kongresi Kombëtar Afrikan)

ASEM – Asia and Europe Meeting; (Takimi Aziatik dhe Evropian)

BIM – Ludwig Boltzmann Institute of Human Rights, Vienna, Austria; (Instituti për të Drejtat e Njeriut Ludwig Boltzmann, Vjenë, Austri)

CCW – Convention on prohibitions or restrictions on the use of certain conventional weapons; (Konventa për ndalimin dhe kufizimin e përdorimit të armëve të caktuara konvencionale)

CEDAW – Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women; (Konventa për Eliminimin e të Gjithave Formave të Diskriminimit ndaj Grave)

CERD – United Nations Convention on the Elimination of All Forms of Racer Discrimination; (Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor)

CESCR – Committee on Economic, Social, and Cultural Rights; (Komiteti i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)

CJ – Citizens Juries; (Juritë e Qytetarëve)

CRC – United Nation Convention on the Rights of the Child; (Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës)

ECHR – European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms; (Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale)

ECOSOC – Economic and Social Council; (Këshilli Ekonomik dhe Social)

ETC – European Training and Research Center for Human Rights and Democracy, Grac, Austria; (Qendra Evropiane e Trajnimit dhe Hulumtimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci)

EU – European Union; (Bashkimi Evropian)

EUMC – European Monitoring Center on Racism and Xenophobia; (Qendra Monitoruese Evropiane për Racizëm dhe Ksenofobi)

FARE – Football Against Racism in Europe; (Futbolli kundër Racizmit në Evropë)

FDC – Freedom from Debt Coalition; (Koalicioni Liria nga Borxhet)

FGM – Female Genital Mutilation; (Gjymtimi Gjjenital i Femrave)

GA – United Nations General Assembly; (Asambleja e Përgjithshme e OKB-së)

GATS – General Agreement on Trade Services; (Marrëveshja e Përgjithshme mbi Shërbimet Tregtare)

GC – General Compact; (Pakti i Përgjithshëm)

GDP – Gross Domestic Product; (Prodhimi i Përgjithshëm Vendor)

HDR – UNDP Human Development Report; (Raporti i UNDP për Zhvillim Njerëzor)

HIPC – Heavily Indebted Poor Countries; (Shtetet e Varfëra me Borxhe të Mëdha)

HRE – Human Rights Education; (Arsimimi për të Drejtat e Njeriut)

ICC – International Criminal Court; (Gjykata Ndërkombëtare Penale)

ICCPR – International Covenant on Civil and Political Rights; (Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike)

ICESCR – International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights; (Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)

ICRC – International Committee of the Red Cross; (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq)

ICTY – International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia; (Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë)

IHL – International Humanitarian Law; (E Drejta Ndërkombëtare Humanitare)

IJC – International Commission of Jurists; (Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve)

ILO – International Labour Organization; (Organizata Ndërkombëtare e Punës)

IMF – International Monetary Fund; (Fondi Monetar Ndërkombëtar)

IPEC – International Programme for the Elimination of Child Labour; (Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijës)

MPs – Members of Parliament; (Anëtarët e Parlamentit)

NGO – Non Governmental Organizations; (Organizatat joqeveritare)

NPA – National Plan of Action; (Plani i Veprimit Kombëtar)

OAU – Organization of African Unity; (Organizata e Unionit Afrikan)

OECD – Organization for Economic Cooperation and Development; (Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik)

ODIHR – Office for Democratic Institutions and Human Rights; (Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut)

OSCE – Organization for Security and Cooperation in Europe; (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë).

PDHRE – People's Movement for Human Rights Education; (Lëvizja Popullore për Arsimim për të Drejtat e Njeriut).

PRODEC – The Decennial Development Program on Education; (Programi Dhjetëvjeçar për Zhvillim Arsimor)

PRSPs – Poverty Reduction Strategy Papers; (Punimet Strategjike për Reduktim të Varfërisë)

SAPs – Structural Adjustment Programmes of the World Bank; (Programet e Bankës Botërore për Rregullimin e Strukturës)

SEE – South Eastern Europe; (Evropa Juglindore)

SIM – Netherlands Institute of Human Rights, Utrechts, Netherlands; (Instituti Holandez për të Drejtat e Njeriut, Utreht, Holandë)

TRIPs – Trade-Related Aspects of Intellectual Property Rights; (Aspektet Afariste të të Drejtave të Pronës Intelektuale)

UDHR – Universal Declaration of Human Rights; (Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut)

UEFA – Union of European Football Association; (Unioni i Shoqatës Evropiane të Futbollit)

UNCED – United Nations Conference on Environment and Development; (Konferenca e OKB-së për Ambient dhe Zhvillim)

UNDP – United Nations Development Program; (Programi i OKB-së për Zhvillim)

UNESCO – United Nations, Educational, Scientific and Cultural Organization; (Organizata e OKC për Arsim, Shkencë dhe Kulturë)

UNICEF – United Nations Children’s Fund; (Fondi i OKB-së për Fëmijë)

UNMIK – United Nations Mission in Kosovo; (Misioni i OKB-së në Kosovë)

UNMISET – United Nations Mission of Support of East Timor; Misioni Mbështetës i OKB-së për Timorin Lindor)

UNTAET – United Nations Transitional Administration in East Timor; (Administrata Tranzitore e OKB-së në Timorin Lindor)

WCAR – World Conference Against Racism, Racor Discrimination, Xenophobia and Related Intolerance; (Konferenca Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racor, Ksenofobisë dhe Mostelerancës së ngjashme)

WHO – World Health Organization; (Organizata Botërore e Shëndetësisë)

WSSD – World Summit on Sustainable Development; (Konferenca Botërore për Zhvillim të Qëndrueshëm)

WTO – World Trade Organization; (Organizata Botërore e Tregtisë)

WUK Kinderkultur – Werkstätten und Kulturhaus Kinderkultur